

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-1  
RSL

LLAMBRO RUCI



*Shpërthim  
Prilli*

Vjersha dhe poema

814-1

RRL.

LLAMBRO RUCI

# SHPËRTHIM PRILLI

*Vjersha dhe poema*



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## POEZIA

I dua ditët, netët  
plot zhurma e lëvizje,  
më zgjohet ritmi i jetës,  
jehon në këngën time.  
Peisazhin e Atdheut  
me ujra, lisa e limonë  
e ndjej kur lule çel  
e fryn plot me aromë.  
Dhe dallgët nëpër supe  
i ndjej kur më mbulojnë  
plot me petale shkume  
në këngë hijeshojnë.  
Rrëketë e përrenjtë  
e fryrë në pranverë  
si ikin fjalëshumë  
në kraharor i ndjej.  
Gëzimi, lumturia  
burojnë, burojnë paprerë;  
nga jeta e begatshme  
vërshojnë në çdo vjershë.  
Dhe njerëzit e mi,

i njoh apo s'i njoh,  
të shtrenjtë unë i kam,  
mes këngëve i shoh...  
Gëzimin s'e kërkoj  
pas shpirtrave të zbeta, —  
në fusha e uzina  
mes njerëzve e gjeta.  
Më mbeti nëpër duar  
kjo tokë frymëngrohta  
ku qengjat blegërijnë  
si vargje ndër kullota.  
I dua ditët, netët  
plot zhurma e lëvizje,  
më zgjohet ritmi i jetës,  
jehon në këngën time.

## FUND DHJETORI

Mbrëmja derdh pëlhurë të artë me yje,  
zërat e fshatit po qetohen një nga një.  
Një mëllenjë befas klith  
pastaj në kaçube bie e flë. .

Mbi fytyrë më pikon drita e yjeve  
dhe hija e bardhë e maleve.  
Fryn flladi dhe udhë u jap mendimeve  
që nga kopshtet në dihatjen e staneve.

Fund i një viti po shuhet si yjet  
që lenë pas një shteg me dritë,  
na la tryezën e begatshme  
dhe një ëndërr në ison e këngës, te sytë.

## KËNGË PËR FSHATIN TIM NË BREGUN E DETIT

(poemë)

Vjeshta e sivjetme me degë të rënda  
mendjen ma mori, më dehu;  
kokrrat e pjekura m'i përpjek në fytyrë  
harbuar nga ajri,  
uji e plehu.

Kopshteve zbres e ulem mes fshatarëve  
ku na zë hera mbi gurë a nën pemë.  
Pi ujë me gllënjka nga pagurja e tyre  
e me zë të ndezur  
këngëve ua them.

Ulem me ta e këmbejmë mendime  
për çdo punë, për çdo fletë.  
Sytë dhe fjalët i duan të thjeshta, të mira  
si frutet e pjekura,  
që varen ndër degë.

Bukën e thyejnë më dysh...  
Për bijtë frutat i ruajnë sepeteve,  
po vetë s'i prekin me dorë.  
Për ne para kohe  
rrudhen e plaken.

Në thinjat e tyre ka rënë  
meraku e gëzimi për jetën e nipërve e bijve,  
si majat  
që mbulohen me borë —  
kulmet e lartësive.

\*

\*

\*

Me moshatarët djersij në punët e stinës  
ku pikon lëngu i rrushit, i pjeshkës.  
Arkat me ta i mbaj përmbi shpinë —  
gjithë peisazhin e pjekur  
të vjeshtës.

Në sedër jam me ta dhe s'e fsheh,  
diçka bëjnë më shumë se unë  
kur agrumet rrisin në tokën shterpë...  
Kështu na rrjedh jeta plot vrulle,  
pa bujë.

S'i trembemi breshërit e shiut që na lag,  
as erës që degët përthyen.  
Me duar thërrojmë shkëmbinjtë  
që ujërat  
jetën kudo të shpien.

\*

\*

\*

Brigje me damarë guri ku ngurosen stuhitë...  
Moti fryn i gufuar nga deti  
e lulet i ndez, natyra plot hove lëviz —  
në çdo syth e gjethe  
jeta shkrepit.

Këtu kam lënë timbrin, jehonën e zërit,  
prekjen e duarve në çdo rrënjë e fletë,  
kapur pas jeleve të bardha të dallgëve  
kur këngët i nisa  
në jetë.

Kam ndjekur peshqit e fluturat,  
gjymtyrët i çora ndër ferra pas zogjve.  
Me dorë i preka gjithë bukuritë  
që syri më kapte  
te ty vendlindje.



Me mushkën dilja çdo pasdite  
gjer atje larg ku bari fëshfërinte.  
Gjithësisë i recitoja Naim Frashërin,  
zogjtë brofnin,  
mushka zilen tringëllinte.

\*

\*

\*

Në ato vite jetuam ngjarje të mëdha  
me kooperativën që hyri në fshat,  
me të tjera udhë, të tjera dashuri,  
me socializmin derdhur në ëndrra,  
në gjak.

Një nga një u shkulën gjerdhet  
dhe kufijtë mes zemrave — udhë të ngrira.  
Më e bukura ditë kish rënë në vendlindje  
e unë si deti,  
nga hareja buçisja.

Oborret mbushur si në dasma,  
kënga hidhej lart  
si e prerë dallge.  
Me sytë te yjet ëndërronim  
të afërtën të ardhme...

\*

\*

\*

Gjurmët e hapave kërkoj në ledhet që ngritëm  
sa herë rrebeshet u derdhën me vrulle.  
Të hapej dita kurrë nuk pritëm,  
me gjoks e premë shiun,  
erën me shkulme.

Po rruga s'ish e lehtë gjer te kjo ditë.  
(Lufta ende s'ka sosur.  
Shpirtrave akoma rrëmon si insekt me brirë,  
kjo «imja» e «jotja»  
me dhembje e brejtje).

S'ish e lehtë të ndaheshim nga sinoret,  
mëkëmbur me halle nga brezi në brez,  
po kooperativa i shkuli  
si pemë të kalbura  
me rrënjë e degë.

Dhe fshatarët e mi  
jetën mes punëve e gëzimeve  
e lanë,  
çdo bime si fëmijëve  
dashuri, përkujdesje i dhanë.

\*

\*

\*

Të gjithë armiqtë, kulakët, në ballë  
flamurët e vjetër i nxorën nga varri:  
për një krodhe bukë do të ngordhim  
se na vate gjëja,  
malli!

Mes territ ky zë  
pëshpëriste e fshihej —  
zëri i egër i armikut të klasës.  
Fshatarët e mi kokat tundnin  
dhe përplasnin mbi të pëllëmbën e ashpër:

— Hesht, se të pamë kur gjermanit  
i dhe bukë e mish dhe shtigjet e malit ia the,  
ti, ballist, me armë e florinjte e fshehur luftove  
që kurrë të mos bëhej  
ky Atdhe.

— Hesht, se në dyzet e pesë  
votën dhe zemrën në kutinë e zezë mbylle.  
Me syrin nga deti prisje gjemi e vapore  
të zbarkonin englezët  
si karavidhe.

Kooperativa u ngrit  
po të gjitha s'u thyen:  
norma e zakone — sinore të vjetra, —  
sigurisht përditë këpusim diçka  
dhe e flakim rrugës nga vetja.

\*  
\*                      \*

Brigje të thatë, të zhveshur,  
guri thërrmohej nga vapa.  
Stërgjyshërit  
me sy e shpirt të etur për jetën  
u ngulën në këto vende të ashpra.

Kërkuan kripën në shkëmbinj  
ku u përthanë stërkalat.  
Mbi kokë u rrihnin krahët  
e klithnin në ikje  
pulëbardhat...

Shtrihen rrënjët e jetës  
në rrëfimet e qeta të pleqve,  
që u endën në dhera të huaj —  
herë në stere,  
herë në dete.

Mblodhën ullinj,  
u mbyllën në mina ari, qymyri.  
Dhera të huaj —  
buka ish e hidhur,  
i përgjysmuar gjumi.

\*  
\*                      \*

Nga mjekra e priftit  
kullonte vera e vaji,  
kandilat përpëlitnin sytë e mekur  
mbi të gjallë,  
mbi të vdekur.

\*  
\*                      \*

Partia hyri  
me pushkë e gjëmime,  
ligje të reja Këshilli nënshkroi.  
I varfëri zot i ujit dhe tokës  
këngën e bukës në mbledhjen e fshatit këndoi...

I ruajmë akoma litarët,  
tokat me to na mati Reforma.  
Gjer vonë ahere i ndiznim fenerët,  
përgjonim aganë, zengjinët  
mos shfaqeshin prapë nëpër ara.

Fshatarët e mi  
kokë më kokë mblidheshin.  
Natën rrotulloheshin në gjumë,  
tokës i flisnin me emër  
si fëmijët të shtrenjtën fjalë «nënë».

E zgjoheshin, pragjeve dilnin,  
dridhnin një cigare të trashë e heshtnin.  
Toka dridhej nga filizat që piqte në gji,  
ata tutje-tëhu  
nga gëzimi zienin.

\*

\*

\*

Si gjithë fshatarët e mi  
kam rrënjët e jetës të gjelbra,  
shtrirë thellë në një limon, në një ulli,  
lulëzuar  
mbi shkrepë të egra.

Jetën e njerëzve lexoj në çdo degë portokalli,  
në shkëmbinjtë e thyer, në sytha e kokrra.  
Dheu i zi, mbartur në kurriz nga mali,  
gjak i njerëzve bëhej,  
bukë nëpër kohëra.

Nënat sa një grusht u bënë  
në shtigjet e gjata  
nga anëdeti te stani.  
Ndaj kaq lule çelën ndër dritare,  
ndaj aq kokrra lidhi portokalli.

Bukurinë s'e humbën gërxeve të thatë,  
bukuri e tyre çeli në lule ftoi.  
Ra pranvera kopshteve e vreshtave,  
pemët plot me fruta  
i ngarkoi.

Nënat i sollën mbi shpinë të gjitha  
këto lule,  
këto fruta.  
Nuri i fytyrës e drita e syve u mbeti  
në çdo kokërr e degë që këputa.

Nënave u dhimbset kooperativa,  
ndaj një kokërr ulli dëm nuk lënë.  
Pikën e ujit kursejnë në vaditje,  
pikën e ujit  
shtrydhin rrënjë më rrënjë.

\*

\*

\*

Hyni, hyni në këngë, fshatarët e mi,  
me duar të ashpra si guri, me baltë,  
vajza me Rivierën e bukur në sy,  
me shaminë me lule  
mbi ballë.

Në pëllëmbë s'vështroj rrugët e fatit,  
në to nisin udhët e bukës e shtigjet e së bukurës  
shtrirë tejmbanë fshatit,  
pas gjurmës së ujit  
e hapit të mushkës.

Me djersën e ballit mbi gurë  
tarracat si vetull i çelëm,  
kokrrat e ëmbra fërkohen  
e flakë ndezin  
qiellin e kthjellët.

Ne gëzojmë e armiku tërbohet,  
armiku që pret nga deti një erë,  
që kokrrat një nga një të rrëzojë  
e pemët të ngelen  
kërcunj. nëpër erë.



Po motin e armiqtë s'i lëmë dorë të vënë  
mbi djersën e derdhur — lëngun e pemëve,  
natën e ditën më këmbë të tërë  
përballë kohës,  
përballë erërave.

\*


\*

\*

Vjeshta e sivjetme me degë të rënda  
mendjen ma mori, më dehu;  
kokrrat e pjekura m'i përpjek në fytyrë  
harbuar nga ajri,  
uji e plehu.

Vajzat nën ullinj,  
një këtu, një atje, sikur mbledhin lule,  
mbushin grushtet me kokrrat e shndritshme,  
thasët fryhen, çohen më këmbë  
me peshën dhe aromën e bukës së shijshme.

Me duart e ashpra, të çara  
prek vjeshtën me aroma e kokrra plot lëng;  
dal kopshteve të vjel nëpër erë e shi,  
si gjithë fshatarët  
dhe unë.



Gishtat më dhembin, ftoma më hyn nëpër koska  
dhe grushtet më djetin sikur mbaj kongjij,  
por peshën e bukës mas nëpër kokrra,  
e syri në gjithë hapësirat  
më çelet, më ndrin.

Netve era gërvish në dritare  
e ullinjte kërrusur nga prodhimi pëshpërijnë,  
fshatarëve gjumi u del e vënë veshin  
në hapësirën e natës  
me zemër të ngrirë.

U dhimbset si njeriu një degë e thyer  
nga pema që i ndenjën mbi kokë,  
kur shiu i lagu  
e në trup u hyri  
acari dhe era e ftohtë.

\*

\*

\*

Vjeshta e sivjetme me degë të rënda  
mendjen ma mori, më dehu,  
kokrrat e pjekura m'i përpyjek në fytyrë  
harbuar nga ajri,  
uji e plehu.

\*

\*

\*

Shtëpi të bukura, të bardha,  
me hije, lule e dritare shumë,  
nga vijnë e çukisin zogj e crëra  
dhe thonë këngë  
e lodra bëjnë.

Kërcasin dyert në mbrëmje,  
radio e televizorë anembanë,  
oho, na shpon në zemër  
kënga piluriote  
me brengën e çobanit lart në stan.

Në dimër a në vjeshtë  
rrugët marrin nëpër ujëra,  
rrugët zënë nëpër kopshte  
që nga gjyshet  
gjer te vajzat e urta.

E pleqtë bluajnë nëpër mend  
këngë e dasma të ardhme,  
kur arkat mbushin gjer në buzë  
kokrrat që ndezin vendin  
ngjyrë alle.

Vajzat si nure i vështrojnë,  
s'u ngopen hireve të tyre:  
— Ku i keni sytë, vulëhumbur?, —  
darkave  
u kanosen bijve.

\*

\*

\*

Kush më shumë se fshatarët, kush  
i njeh me emra gjithë agrumet,  
njeh pjellorinë e tokës, erën e plehut,  
stinët kur çelin  
e kokrra lidhin lulet?

Fshatarët e mi ruajnë në gjokse shumë këngë,  
ritme e harqe vallesh  
mu si shkumë vale  
shkruar nëpër luftra  
ndanë një guri a nën portokalle.

Nuk shkulen nga shtëpitë  
se janë themele — vetë vendlindja.  
Gjersa këmba të na rrahë përmbi gurë  
do krasitim pemë, thonë,  
do ngremë ullinjte ndër brinja.

Ndaj jetën e lëmë në çdo gjë që prekim,  
guri shpërthen e çel lule,  
nëpër kopshte të na gjejë vdekja  
e t'i themi: prit, moj firaune,  
se më mbeti pa shartuar shega!

Dhe bijtë e bijat që u kthyen nga qytetet,  
nipërit që pragjet s'i harruan,  
krahë do t'u bëhen punëve,  
kulme të reja strehëve  
e dritë luleve.

\*

\*

\*

Kur shkoj nëpër vendlindje  
s'i bie përmes rrugës së madhe,  
po kërcej prapë në të vjetrat shtigje,  
ku janë shkukur ferrat,  
ku është korrur bari.

Mes kopshteve nënën e shtrenjtë takoj  
me duart në prodhimet e vjeshtës,  
nëpër buzë e hapësirave ndjej aromat  
dhe lëngun e rrushit,  
fiqve e pjeshkës.

Me fshatarët ulem e dredh cigare  
me gishtat e trashë, e heq me merak...  
Dhe them: këtu veten e ndjej mirë,  
mes njerëzve të dashur  
në vjeshtën e artë.

Me pleqtë rri e këmbej mendime  
për tokën dhe prodhimet, natyrisht,  
për politikën dhe pensionet që gëzojnë;  
veç nga kopshtet  
s'shkulem asnjë ditë.

Nga krasitja e pemëve  
mësoj që në vjersha  
bukurinë e jetës të jap të shëndetshme,  
ta kërkoj aty ku rriten buka e prodhimet,  
kudo ku derdhet djersë e ndershme.

\*

\*

\*

Vjeshta e sivjetme me degë të rënda  
mendjen ma mori, më dehu;  
kokrrat e pjekura m'i përpjek në fytyrë  
harbuar nga ajri,  
uji e plehu.

## Z A H O K O K A

Zaho Koka, i bukuri  
si yjet  
që ulen te Çika,  
fryn jugu  
dhe himariotëve  
përpara u prin  
nëpër gryka.  
(Qenë shembur pjergullat,  
lëngu i rrushit  
i hidhur  
pikonte në buzë).  
Ti kapërcen Mjegulloshin,  
me lajme  
vjen te ne gur më gur.  
Plumbi i nxehtë  
në grykë të Moretit  
rrjedh gjak  
dhe zbraz dufin  
e gjithë Bregdetit.  
Zaho Koka, i bukuri  
si yll

që Çika ndezur e mban,  
në sytë e fëmijëve,  
në gjestet dhe hapat e tyre  
ke mbetur  
me thirrjen «Para partizanë!»



## DASMË NË FSHAT

Era fryn në oborr,  
ullinjte kërrusen,  
zogjte me cicërima  
nëpër këngë futen.

Këngët e dasmës  
ç'u përhapën fushës,  
lulet nxorën sytha,  
shamitë nxorën nuset.

Kënga në oborr,  
porsi hark dallge,  
krushq e dasmorë  
i rrëmben në valle.

\*

\*

\*

Bajame e bukur  
vështro rreth e qark,  
gjithë fshati, moj,  
të erdhi në dasmë.

Shoqet dhe shokët  
dhëndrin kanë në mes,  
ç'i shkëlqejnë sytë,  
ata sytë e zes.

\*

\*

\*

Seç gjëmon traktori  
thellë në çdo plis,  
zogjtë brofin nga këngët  
te Bajamja vijnë.

\*

\*

\*

Bajame e bukur,  
djalit çfarë i the  
kur t'u ndez fytyra  
e kuqe si re?

Qeshnit e gëzonit,  
shkelnit nëpër muzg...  
Ditë e dashurisë  
mos mbaroftë kurrë!

\*

\*

\*

Prapë ti na je  
në brigadë e para,  
hidhesh si thëllëzë  
në brinja, në ara.

Duart e ashpra  
grisur nëpër ferra,  
çarë nëpër degë  
nga shiu e era.

S'di se ku t'i vësh —  
të mëdha, të rënda...  
Ç'e trazon shaminë  
me mendjen te nëna...

\*

\*

\*

Vallja ndizet flakë,  
kupave rakia...  
Oh, dhe në u dehçim  
veç nga lumturia!

Pleqtë edhe plakat  
kusure nuk lënë,  
faq, dalin në krye  
si petritë në këmbë.

Gjithë fshati, moj,  
të erdhi në dasmë —  
në punë e në këngë  
është krushk i parë!

## VJESHTA DHE FOLETË E ZOGJVE

Vjeshta kaloi  
mbi parkun me drurë  
me kopan të erës  
shkund e shkund...

Mbetën foletë  
pa cicërima,  
po nuk mërdhijnë,  
s'ndjenë drithma:

— Në gjoks na rriten  
krahë zogjsh  
pranvera që vjen me sythe  
na deh, na josh.

Zogjt' e bukur  
ngado në atdhe  
gjithçka që panë  
do na thonë ne

me fjetet e barit,  
zërat e punës  
mbledhur malit,  
mbledhur fushës...

## TË ARRISH NJERËZIT

*Jerasimos*

Çdo çast ndërrohet peisazhi;  
pellgjet ku krihej hëna  
ku rrodhën, nga vanë?  
Kallamishtet që na gërvishnin vështrimin  
ku u përthyen e ranë?

Shpejto të arrish në fushë  
ku hapet si lule  
dielli i madh i ditëve  
në rrugët plot me vogëlushë,  
në sytë e kooperativistëve.

Dhe do gjesh  
trupat e kallamave të prerë,  
dhe do gjesh shtegun që thau pellgjet  
në duart e forta me gjurmë balte  
ku mbruhën të vrrullshme ditët, netët.

Duhet skicuar mëngjesi,  
dritë-hijet që qarkojnë parcelat,  
të shpërthejë në tablo  
fushë e ngopur  
me të mbjellat.

Shpejto të arrish njerëzit  
me hijen e bardhë të gonxhes së çelur  
rritur nëpër sy,  
të kapësh gjurmët e peisazheve të rinj  
që skicohen në imagjinatën e tyre të ndezur.



## NDËRGJEGJE

Në mbrëmje tek kthehej nga puna u step  
pranë vijës së ujit që derdhej më kot,  
ndoshta agrumet rrëzuan ca fletë,  
ndoshta kurorat i varën gjer poshtë...

— Sikur të ishte kopshti im, —  
tha, — s'do lija të humbte një pikë me ujë,  
po sot që të gjitha ne i gëzojmë,  
të shohim si njeriun çdo rrënjë!

Pëllëmbët ngjeshi në dheun e butë  
dhe uji rrodhi rrënjë më rrënjë.  
Oh, ta kish pranë dhe mund ta rrihte  
atë që s'punon po flë në këmbë...

Ujin e ndoqi nëpër kopshte,  
lodhja rrodhi me ujin ndër agrumc,  
do piqeshin më shpejt kokrra të ëmbla,  
do çelnin më shumë të bukurat lule.

## PARTIZANI I VOGËL

Armik i egër ardhur nga Prusia,  
më trembe zogjtë, —  
më ikën të plagosur;  
barin e shkele që në rrënjë,  
ç'm'i vrave shokët dhe lodrat e mia.

Për baltën që më more nëpër këmbë,  
për çdo gllënkë uji që më pive,  
zemra,  
si zog i vogël, më dhemb  
dhe më është zbehur kaltërsi e syve.

Udhën ta këputëm, të shembëm me plumb  
ty, nazist,  
me syrin e shqyer si hon;  
mbi ty sa pushkë shkrehëm në luftime,  
sa emra lamë si yje të rrezojnë.

Dhe zogjtë erdhën prapë me cicërima,  
bari fletë-fletë më thërret në lodra,  
prapë dola kopshteve e brinjave  
me yllin e kuq  
që më digjet te koka.

## MOTIV AUTOBIOGRAFIK

Ç'thanë gjyshet e fshatit, ç'thanë  
atë mbrëmje dimri të dyzetegjashtës  
kur erdha në botë me britma,  
kur me lulet që ndau Reforma Agrare  
më mbuluan mirë  
të mos mërdhija?

Për mua kuvenduan,  
birin e bujkut;  
mes ninullave të buta si ëndërr  
nën jastëk më vunë  
kokrrën e ftoit  
e degën e nerënxës:

— Udha të priftë në det,  
i hidhur është uji kur çahet stuhia!  
Udha të nxjerrtë tej malesh, o trim,  
i egër është guri atje  
me leqe dëbore!...  
Këtu si krua të rrjedhtë djalëria...

Më këmbë unë s'ngrihesha dot,  
t'u flisja gjysheve të mira:  
— O nënat e fshatit  
me thinjat plot derte, gëzime,  
unë shtigjet e reja do marr  
prapa çdo vetëtime!

Kohët ndryshe po rrjedhin, aq ndryshe...  
e deti s'më trëmb  
kur nxin e zbraz dufin,  
as mali me tërsëllimë,  
që lisat si cingla i shkul  
e tutje i flak, o të dashurat gjyshe!

Udha ime do shtrihej mes deleve e kopshteve  
përkundur në vrulle e ëndrra  
si mbi samar të mushkës;  
për të gjitha do buronte frymëzimi:  
për njerëzit dhe fletët  
e dritën e pushkës.

E larg në se ika  
ku më thirri socializmi  
pas dritave e këngëve të jetës,  
në çdo gur të vendlindjes ballin ngjita  
dhe dorën tek arma  
në këmbëzën e shkrepjes.

Në çdo zë e drithmë buzësh  
mallin e njerëzve marr.  
Si mund të rri vetëm,  
si mund të hesht  
kur kënga e jetës  
si dallgë më buçet?!

## JETA PËRRETH MË BUKUR NA I THA...

Të heshtur ecnim dorë për dorë  
shoqëruar nga ylli i mbrëmjes,  
krisnin shegët dhe lëngu i tyre na skuqte buzët,  
çaheshin pjeshkët nëpër natë,  
binin në përparsen e saj të mugët...

Të heshtur ecnim dorë për dorë drejt shtëpisë,  
dhe pse s'flisnim, brenda njëri-tjetrit qemë.  
Ç'të ngjitesh gjer te yjet,  
ç't'u thuash luleve,  
të gjitha përpara i gjen:

Dy krahët fërgëllues të zogut,  
rrugën e yllit dhe lëngun në fruta.  
Vendlindja i derdh rrahjet e jetës  
në sythat që çahen me krisma të buta.

Edhe pse heshtëm një çast  
e s'thamë dy fjalë intime  
jeta përreth më bukur na i tha  
të ngrohta, plot kumbime.

## SHTIGJE TË ÇELURA

Fshati me shtigje të çelura  
më pret si çdo bir,  
unë zemrën vë  
në këtë hapësirë.  
Karpuzi kërcet,  
pjeshka çahet nga kënaqësia,  
si pjergull vjeshtore  
mbulojnë peisazhin  
ëndërrimet e mia.

Me farë gëzimi të bujshëm,  
me gjëmime traktori  
në shpate,  
bukuria gjendet  
në çdo pikë djerse,  
në çdo gjurmë balte.

Atdheu kudo  
vendlindje më bëhet,  
i shtrenjtë, —  
jetën ia jap,  
rini e këngë.

Fshati me shtigjet e çelura  
më pret si bir,  
unë duart dhe zemrën vë  
në këtë hapësirë...



## HIMARIOTE

Një ia merr  
sikur po sjell  
një lajm lufte  
tutje-tutje,

tjetri ndalet  
ia kthen, —  
isoja zgjatet,  
të rrëmben.

Kokë më kokë  
një zë, një shpatë,  
mbi shpatulla armiqsh —  
tramundanë.

Rreth e rreth  
klith rrufeja, lufta;  
gjoksburojë —  
kënga, pushka.

Dhe pastaj  
shtruar-shtruar  
një shamizë qielli  
mbi sytë e shkruar.

Shkriu bora  
majave,  
hyri prilli  
zemrave.

## ËNDËRR LIRIKE

Në mes shoqesh ndanë një kroi  
vetëtijnë dy sy të zinj;  
tërë lulet çeli ftoi  
nuses t'i stolisë gjinë.

Uji brof e merr me vete  
bimëve rrënjë më rrënjë  
dëshirën si lule ftoi  
të nuses që bëhet nënë.

## B U K A

Në bukën e bardhë të ngrohtë  
mbi tryezë, thyer në mes,  
gjej lodhjen dhe prekjen e duarve  
të qindra njerëzve të thjeshtë.

Dhe zërin e nënës dëgjoj që më flet  
me timbrin e njohur, të butë:  
«Mendoni për bukën që shtrohet në sofër,  
kush i ndënji në kokë, kush?»

. . . . .  
Në bukën e bardhë të ngrohtë  
mbi tryezë, thyer në mes,  
gjej lodhjen dhe prekjen e duarve  
të qindra njerëzve të thjeshtë.

Ndaj bukën kursej dhe për ta mendoj  
jo vetëm kur ulem në sofër, —  
draprin rrëmbej dhe ditën e diel,  
kallinjte të mbledhim kokërr më kokërr.

Nëna ime, si gjithë nënat, e bukura —  
me sytë te shtegu i malit;  
tërë udhët rrahin krahët si flutura  
në ballin e saj me mall.

Ka nderur në oborr çarçafët e bardhë  
dhe pritjen në portën e çelur.  
Përherë na pret nëna me zjarr,  
me sytë te udha e dredhur.

Malli i ndezur faqeve  
nënat i rinon njëqind herë.  
Në flokë le të ulet dëbora e zambakëve,  
bijtë mes syve i kanë  
ngado që janë, ngado që venë!

## POEMA E PARË PËR DASHURINË

Mos më qorto, e dashur,  
pse ende s'e thura  
poemën e parë për dashurinë;  
po unë e ndjeja tek piqej  
në ndërgjegjjen time,  
ashtu si frutat  
pas luleve vijnë.

Më duhej të ngrihesha  
netve në aksione  
dhe tarraca të çelja në rrënjët e shkurreve,  
të qëndisja  
në gjergjefët e hapur të shpateve  
trupat e gjelbër të agrumeve.

Kështu vija drejt teje, dashuri,  
me fytyrën rreshkur  
nga dielli dhe erërat,  
ku kërcente në vijat e holla  
të dejeve e rrudhave  
mendimi për ty...

Në pragjet e Atdheut  
llampa vura e çelësa shkrepa;  
vërtet të recitoj nuk di mirë,  
po nga hareja brohorita:  
— Ditë e re, tungjatjeta,  
tungjatjeta!

\*

\*

\*

Kështu hyra në jetë  
pak i vrenjtur nga mendimet:  
me gjurmët e vendlindjes  
nëpër sy,  
hovet e jetës  
dhe vezullimet.

Frymëzimin e ndera në udhë  
pas njerëzve që thellë i desha,  
me ta shpumë linjat e dritës  
fshatrave,  
bëmë vjersha.

Ka hekur, aroma jugu  
dhe vrulle rinore kënga ime.  
Çelikun dhe lulet  
i gjej pranë e pranë  
në prehrin e ëmbël  
të tokës sime.

\*

\*

\*

Kokën ngrita një ditë  
nga telat e nga vjershat  
dhe të pashë thellë  
në sy,  
motivet më rrethuan:  
Për ty, për ty!...

Sy të mëdhenj, të butë,  
fytyrë e vogël,  
e urtë;  
drita vete vjen nëpër sy,  
buron paprerë  
dashuri!

Sytë e bukur xixëllojnë  
si një yll,  
drita vete vjen  
si hënë e plotë  
nëpër pyll.

Sy të mëdhenj,  
të zinj,  
kanë brenda farën e gëzimeve:  
vetëtijnë  
me forcën  
e gjithë ëndërrimeve.



Po unë heshta,  
si një dru në shkrepëtimë,  
fjalët ia hodha erës e i mori me vete;  
mbase u bënë zogj,  
mbase u bënë lule  
e të erdhën në parvaz  
atë ditë vjeshte.

Më të bukura u bënë atë ditë  
rrugët, dritaret,  
të gjitha;  
dhe njerëzit më të shtrenjtë  
m'u bënë,  
në zemër thellë i kisha.

\*

\*                      \*

Me gjithë motivet,  
e dashur,  
m'u mbështete në gjoks, —  
rrahja e zemrave  
përkund horizontet,  
krahë të jep, moj botë!

\*

\*

\*

S'e ndjenim trishtimin e gjetheve  
(në vjeshtë, eh, sa zëra thonë!)  
kur shkelnim mbi to  
si mbi murmurima të largëta.  
Pranvera po zbriste  
me vrape ujërash  
bulonte me lule shtigje e qafa.

Dhe cipa e hollë e muzgut,  
ndehur  
si lëkurë e hollë dauulleje,  
kumbonte nga gazi  
e hapat  
që shkelnin nëpër mbrëmje.

Ish vjeshtë  
po me lulet e freskëta të brinjave  
i mbulova flokët e tua  
dhe zemra e dehur  
këndonte:  
— Të dua, të dua!

\*

\*

\*

Butrinti

heshtjen shkund nga topat, muret e ndërtesave.  
Muzikë e jetës njerëzore  
vërshon e me potere  
qyteti zgjohet e portat çel  
si dikur me rënien e trompetave.

Natyrisht, e dashur,

ti s'je gur kalaje  
as statujë e lashtë në mermer,  
ndaj dot s'të mban asnjë dorë mamaje,  
asnjë pus  
zërin nuk ta merr.

Jeta s'bëhet llogari bakalli —

falle mblesësh me kravatë;  
rruga është e hapur para teje:  
dëgjo zemrën  
që troket, troket...  
dhe udhët hap.

S'erdhëm t'i përulemi

në gjunjë Apollonit në Butrint,  
as botës së kanuneve të rëndë,

po nga gjumi të shkundim  
të parët që ikën  
e s'mundën të duheshin  
si ti dhe unë...

\*

\*

\*

Një pulëbardhë që çan mes zërave,  
pranë bregut vete vjen e klith,  
qepallat na gërvish me krahë  
dhe kaltërsitë  
mbi supe të na rrinë  
me sqep i grish.

Nga thellësitë vijnë  
zërat e paraardhësve,  
ëndrrat koloviten prapë,  
të vëna në litar e plumb,  
ëndrrat  
e nënave, vajzave.

Dashuri —  
fjalë e ashpër, e shtypur  
në ato kohëra;  
të binte përsipër kanuni  
dhe mishin ta grinte  
copa-copa.

Mund të ishin djemtë e hijshëm,  
vajzat belkëputura,  
gishti i mblesëve  
çonte në kurorë  
pleqtë me të bukurat.

Dhe heshtja mpinte ndjenja e vatra,  
varfëria lihte te pragu,  
ditët më të rënda vinin  
me një burrë  
që jetën me tërkuzë zakoni ta lidhte,  
me pranga.

Me opinga lëkure lope,  
brinjë më brinjë u çorët,  
o nëna, që na sollët në jetë.  
Lulëzoi te ne  
gjiri  
dhe buka që nga guri nxorët!

Ndaj pak është të këndosh për nënat,  
të ndjesh dhembjen e tyre.  
S'mjafton fjala e zgjedhur  
si brilant,  
fjalët e rralla si yje.

Për nënat duhet të ndjesh  
gjer në thelb botën e sotme,

të rrish pa gjumë për Atdhenë,  
e të thyesh me trup  
tehun  
e çdo shqote.

\*

\*

\*

Në Butrintin e lashtë  
mes gurëve e lulëzimit të drurit  
kanë rënë jehonat e dasmave ilire;  
dëgjo, po dridhen, rrjedh prapë jeta  
në telat e një lire.

Ne ngjajmë me stërgjyshërit,  
gjaku valë na rreh në damarë,  
po sytë dhe zëri ynë  
nga ditët e reja  
dritën dhe forcën i kanë.

\*

\*

\*

Me gjithë motivet,  
e dashur,

m'u mbështete në gjoks, —  
rrahja e zemrave  
përkund horizontet,  
krahë të jep, moj botë!

Në mbrëmje anëdetit,  
me kokën mbështetur në duar, mendoja:  
— Do ishe gjithnjë e urta, e mira,  
me të qeshura  
të shkonim në gëzime  
dhe udhët e vështira?  
Do kishim tok  
një zemër, një udhë  
e një ëndërr?

Tim eti e nënës  
ç'do t'u thoshe vallë;  
do ishe kaq e mirë,  
zemërbardhë?

Se jeta s'shkohet me premtime,  
me zhurmë a me lotë;  
jeta  
na do me shpirt të pastër,  
me shtëpinë  
mbushur miq e shokë!

Po dallgët me aromë kripe  
imazhe lulësh  
me stërkala më hidhnin  
dhe befash prapë në det  
me rrëkeza binin . . .

Dhe dallgët më sillnin  
fjalët e tua:  
— I dashur, ç thua?!  
Të dua, të dua!

\*

\*

\*

Njerëz të zakonshëm jemi  
si gjithë të tjerët,  
ngrihemi syqeshur e vemi në punë,  
me gazetën e ditës në xhep  
çdo mëngjes herët.

Gazetën çelim  
e prapa fotove, shkrimeve  
ndjejmë peshën e dashurisë, peshën e rrugëve  
në trupin e fjalës,  
në ritmin dhe vrullin e këngëve.



Ky është himni i jetës,  
dashurisë,  
që na lidh si rrënja me rrënjën,  
kështu bëhemi dyfish të ndieshëm,  
të bukur dyfish.

\*

\*                      \*

Më thanë  
(shpirtvegjël qenë sigurisht!) :  
Çdo dashuri — gabim i jetës është, —  
po deshe hiq e vuaj,  
se s'gjendet lot e vaj  
që dhembjen  
të të shuajë.

Po ti, e dashur ,  
e afërt më je në ritme e mendime;  
çdo ditë e më tepër  
të dua më shumë  
me këtë ndjenjë prush —  
triumf i jetës sime.

Në dritën e syrit të shoh  
dhe gjej hijen e bardhë:  
të lules së nespullës,

dhe gjej një hapësirë  
ku ëndrrat piqen  
si pjergulla në trungun e vjeshtës.

E dashur, të dua  
prekjen e duarve, zërin, —  
një mijë bilbila me ligjërime  
s'e shprehin dot  
shpirtin tënd  
plot drithma e vezullime.

Me zërin plot kumbime  
dhe vështrimin e qeshur  
vrapirojmë udhëve të dy.  
Një qiell i tërë pranveror  
i kthjellët, i ndezur  
na gumëzhin nëpër sy.

Me faqen e ngrohtë  
si trëndafil,  
me duart e vogla në qafë ...  
Pranvera e jetës lulet i çel  
në sy, në buzë, në çdo fjalë.

Heshtja perëndon pas krahëve...  
Dalin xixëllonjat  
e si vathë llamburitës nëpër natë  
na vërtiten përreth,

në udhën e shtëpisë na shpien  
si një gjerdan i zjarrrtë.

\*

\*

\*

Me gjithë motivet,  
e dashur,  
m'u mbështete në gjoks, —  
rrahja e zemrave  
përkund horizontet,  
krahë të jep, moj botë!

# KUPTIMI

## I

### JETËS

Ngremë në imagjinatën e ndezur  
ditët e nesërme,  
pregatisim ardhjen e tyre.  
Kumbimet, tiparet ua njohim  
si dashurinë në dritën e syve.

E ardhmja s'çel vetëm  
në këngë e ëndërrime,  
në çdo vepër gjendet  
përzier me çelikun e kohës sime.

S'na qëllon asgjë vetëtimthi,  
asgjë s'është fatale në rrugën tonë,  
e madhërishmja luftë e klasës —  
himn i jetës gjëmon, gjëmon...

Komunizmin e ndjejmë mes lëvizjes e jetës, —  
dashuria dhe rinia e botës,

me emrin e tij themelet i ngremë  
dhe copëtojmë çelikun e shqotës.

S'na qëllon asgjë vetëtimthi,  
asgjë s'është fatale në rrugën tonë,  
e madhërishmja luftë e klasës —  
himn i jetës gjëmon, gjëmon. . .

## DRITA E SYRIT TË KALTËR

(poemë)

Në heshtjen solemne të inaugurimit  
po shkrep çelësin e parë...  
Dhe ndjej nëpër gishtërinj  
të më rrahë si zemra  
një hidrocentral.

Vështroj përreth...

— Ku shkoi pylli i lashtë me lisa?  
Zogjtë rrahën krahët me legjendat në sqep,  
i mori rrjedha,  
e kaltra, e brishta.

Erdhën punëtorët, barakat i ngritën —  
shtëpi të gëzuara në erë e shi,  
marrë nga një kantier në tjetrin,  
në rrjedha dritash  
nëpër Shqipëri.

I thanë lumit: «Ta duam zulmën  
dhe gurgullimat që ushqen fushën,

veç rrugën do ta çash përmes malit,  
me rrahjen e dallgës  
gjithë shtigjet me dritë të mbushësh.

Do çash përmes bllokadës  
ashtu me dallgë, ashtu madhështor  
duke ndezur miliona drita  
në pragjet e Atdheut  
me kazmë e pushkë në dorë!»

\*

\*

\*

Qenë vitet gjashtëdhjetë  
me tradhtira e vetëtima,  
hepohej deti në erë, por brigjet  
qëndronin trimërisht  
si bijtë e bijat.

Hrushovi tundte kokën tullace  
si skeptër të rreptë:  
— Do mbeteni vetëm  
në katër horizontet,  
o shqiptarë gjaknxehhtë!

Shqipëria ziente metal të nxehhtë:  
— Në na shkelshi pragjet e rënda,

armiq, gati i kemi gjokset,  
gati plumbat!

Gjaku na vlonte nëpër deje,  
gjaku i të rënëve që mbetën istikameve,  
gjithë trimëritë e shekujve  
dhe ëndrrat e brezave  
u ngjeshën në vezmet e dy milionë shqiptarëve.

Revizionistët me fytyrë jezuitësh  
skërmiteshin në ditët e tradhtisë së madhe:  
— Ndërtoni tani  
me kokën e fortë  
diga dhe hidrocentrale!

Por nëpër çantat e fryra  
s'morën dot nga brigjet tona  
asnjë kuotë, —  
me trimëri komuniste ngrihej ky vend  
pëllëmbë e lule, pëllëmbë e barot.

Punëtorët u çuan më këmbë  
dhe u betuan me grushtin mbi ballë:  
— Me thonj e me dhëmbë  
Republikën do mbrojmë  
dhe socializmin mbi supe do mbajmë!



U rritëm si lisa  
në ditët e bllokadës, mes erërave të rrepta.  
Të gjithë u betuam: «Në themelet e digës,  
shkëmbinj do vemë  
grushtet e fortë dhe zemrat!»

\*  
\*                      \*

Në heshtjen solemne të fitores  
po shkrep çelësin e parë  
dhe ndej nën gishtërinj  
të më rrahë si zemra  
gjithë ky peisazh.

Partia na dha forcën e krahut,  
ngjyrën dhe dritën e syve,  
vrullin e brohorimat  
në ditët e sulmeve  
dhe inaugurimeve.

Shkëmbi ish i fortë, i patundur,  
shkëmbin do ta brenim me durim:  
E në moshë bubullofshin pistoletat e minat  
ne do ta shkërmoqnim  
me gishtërinj.

Në çdo pëllëmbë tunel i gdhendën emrat  
punëtorët e turneve në netët e gjata.

Nga pesha e shkëmbit,  
nga vërtiku i lumit  
s'u dridhej fjala as qepalla.

Jeta ish e bukur, e ashpër,  
kish shqetësime, dashuri e lodra.  
Nga pagjumësia këmbët na mirreshin  
po në sulme qenë të parët  
pa le të na sëmbonte mes shpatullash lodhja.

Në tunel ngjeshur trup më trup me shokët,  
në turnet me zhurma e ndjenja të zjarrta,  
thërrmohej si shkëmbi  
rufjania, e egra —  
bllokada.

\*

\*

\*

Shkonim te burimet të dielave e festave,  
te «Syri i kaltër»\*) që ëndrrat na ndizte...  
Po bukurinë e baltës e pluhurit  
në ballë të tunelit  
asnjë Sy i Kaltër nuk e kishte.

---

\*) Syri i kaltër — burimi i ujërave të Bisticës

Të luftosh me shkëmbin s'është e lehtë,  
s'do vetëm sy e fjalë të fortë,  
po mbi të të vërvitesh  
i tëri hekur,  
i tëri koskë.

Qemë ne koskë e pathyer me shpirt komunist  
gatuar në luftën e ashpër klasore  
ku njeriu bëhet i bukur  
dhe ndjenjat  
më njerëzore!

\*  
\*                      \*

Gjumi na rrëzon qepallat  
po nga tuneli s'na iket,  
me këto gjëmime  
si mund të prehesh,  
si mund të të flihet?!

Në fytyrat tona plot dritë  
ra hija e lehtë e një rrudhe,  
burrëria ç'na erdhi para kohe  
me zërin e Atdheut,  
me fjalë nëne:

— Do bëjmë socializmin në zemër të Evropës  
pa le të fshikë fytyrat tona stuhia,  
do rrojmë me bar po qe nevoja,  
që ballin e kthjellët  
të ketë Shqipëria.

Dhe pati ndonjë që rrudhi vështrimin:  
— Ç'do bëhet, ç'do bëhet me ne!  
Rusia careshë do shfryjë rrebeshe  
e dallgë do ngrerë  
në Mesdhe.

Për zverku e zumë tradhtinë,  
për gryke armikun e klasës:  
Ngadhnonim një parti e një popull —  
balli i zjarrit,  
syri i barrikadës!

Kokën përdhe kapitullantë me fytyrë meiti,  
të ardhmen s'e shesim, s'e blejmë,  
mbi pëllëmbë si lule e ngrohim —  
gjak e djersë  
përzjerë!

E rrepta, fitimtarja lufta e klasës  
vështrimin na mprehu, granit-grushtin.  
Thërrmonim shkëmbinjtë dhe erërat,  
indiferentin  
dhe të shiturin, pushtin.

\* \* \*

Dhe ndodhi që u shëmb portali,  
në mesin e rrugës tuneli,  
e uji vërshoi nga lart  
pizg i zi, i rëndë, —  
si vdekja e tmerri.

Po djemtë e kantierit u hodhën me gjokse  
dhe vrullin për fyti ia zunë:  
— S'të lëmë, ujë me trille,  
të lozësh me dritën e jetën  
me krisma e zhurmë...

E rrezikshme ishte të hyje  
në vorbulla uji në terr,  
në udhë përplasej e thyhej dërrasa me hekurin  
dhe dallga dallgën  
nxirrte përtej.

Ideali forca na zgjonte —  
dritën e syve, çdo buzëqeshje;  
të paepur qemë me shkëmbinjtë,  
me ujin që herë-herë na hiqte  
branë me vete.

Burrëria na kish hije  
dhe pluhuri mbi qerpikët dhe puthja pas suksesit.  
Ditët e gëzimet i matnim  
me metrat e avancuar,  
me trupin e tunelit.

Rinia jonë shpërtheu ndër gjëmime:  
ndjemë madhështinë e grykave e plasjeve,  
e në çdo hap ngadhnjimin  
e ngjeshëm me hekur e beton  
dhe si poetë ndjemë frymëzimin.

Kështu u bëmë më të mirë...  
Na mbetën në gjokse ca zëra metali, ca nyje betoni,  
na mbeti mbi supë dora e shokut  
shtrirë ndër uturima buldozeri,  
në bori të shpeshta kamioni.

Punëtori, inxhinieri, drejtori  
me çizme në ujë e baltë,  
(qemë të gjithë gishtërinj të një pëllëmbë)  
me djersë e pluhur  
mbi ballë.

\*

\*

\*

Pa dridhu prapë, motokompresor,  
dhe ajrin grise me fërshëllimat!  
Gjëmo, elektrovoz,  
në zemrën e malit  
thërrmuar nga djemtë, nga trimat!

Kam mall të kaloj mes portalit,  
të lagem prapë i tëri me ujë,  
me bojë të shënoj mbi beton  
kuotat e reja  
që bëmë.

\*

\*

\*

Në heshtjen solemne të inaugurimit  
po shkrep çelësin e parë,  
dhe ndjej nën gishtërinj  
të më rrahë si zemra  
një hidrocentral.

Shtyllat hip e zbrit ndër qafa  
me krahët e shtrirë në ikje,  
telat që mërdhinin në shi  
të etura prisnin  
t'i përshkonin vetëtima drite.

Prisnin rrjedhat e naftës  
drithma korenti në trupa motorësh,  
të dilnin mbi dhe  
e të derdheshin në vrape makinash  
e brazda traktorësh.



Revizionistët me fytyrë jezuitësh  
vështrimin e pjerrët na shtinin:  
— Vetëm si do të bëni vallë  
kur t'u qëllojnë stuhitë  
me shtatin më të tmerrshëm se ky mal?

Gishtërinjtë e çjerrë nga uji e guri  
i ulëm mbi pajisjet:  
ato si abecenë do t'i mësonim  
pa le të qenë të rënda  
sa hieroglifet!

S'ka kala që nuk e merr  
njeriu me ideal komunist,  
dallgën me dorë e pret  
dhe shkëmbin shpërthen  
të rrjedhë dritë...



Buruan fitoret si ujë i kaltër  
nëpër themele veprash,  
flamurët e kuq qiejt i ndezën  
përballë armiqve  
me kërcënime e armë si kthetra.

\*  
\*                      \*

Diellin mirrnim në tunel,  
diellin në drita e fytyra  
dhe emrat mbrujtur me çelik e beton  
i lamë themeleve  
në ndërtesa e diga.

Dashuria do forcën e zemrës dhe krahut,  
do forcën e syve të pastër,  
të ecësh në një hap me punëtorët  
ngjeshur  
në trupin e klasës.

S'i lamë armiqtë  
thellësitë dhe rrjedhat e kaltra  
t'i mirrnin në të ftohtën Rusi  
kyçur vaporëve,  
kyçur në çanta.

S'i lamë të merrnin rrahjet e zemrave tona  
për planin e ri pesëvjeçar;  
mes netve pa gjumë  
pas zërit të Partisë  
prodhuam grurin — armë.

Sytë s'na u mpinë,  
gjymtyrët s'na u lodhën;  
kaliqafë fëmijët dhe ëndrrat  
në valën e punëve,  
pranë armëve i morëm.

\*

\*

\*

Në kantier vinte gjithë Atdheu:  
kooperativat në luftë për bukën,  
fabrikat, uzinat me peshën e çelikut të tyre,  
në vijë të parë kundër bllokadës  
të gjithë ne u ngritëm.

Erdhën shokët dhe etërit me urdhrin e Atdheut:  
do qëndrojmë pa le të gremisen retë,  
do qëndrojmë e bukë më shumë do ketë,  
socializmin do ngremë  
me gjak e me djersë.

\*

\*

\*

Në heshtjen solemne të inaugurimit  
po shkrep çelësin e parë  
dhe ndjej nën gishtërinj  
të më rrahë si zemra  
tërë ky peisazh. . .

Tuneli u ça  
dhe lumi braktisi rrugën e vjetër,  
i mbledhur kruspull  
plot dallgë e furi  
në lopatat e turbinës vërshoi e ra.

Ndërtesat u drodhën dhe linjat u mbushën  
plot ritme të reja industriale.  
Dritat u derdhën diej-diej  
dhe hijet e lashta të kandileve  
dëbuan nga pragjet për fare.

Rrotullohen turbinat  
e drita si ditë shkrepëtin:  
në maja malesh,  
në fshatrat e thella  
buron jeta me gumëzhimë.

Rreh pulsi i Atdheut —  
marrshi i ditëve  
përmes shtyllave  
majë më majë  
në lulzimin e brigjeve.

Punëtorët brohorinë  
dhe kasketat i hodhën përpjetë.  
Duart me vajra e baltë  
zgjatën mbi veprën —  
krijesën e shtrenjtë.

Dhe morën udhët prapë,  
bllokada të thyhej në fronte të tjerë,  
drejt çelikut e dritës,  
në gryka e fusha,  
nëpër kantierë.

## SARANDA NË NJË DITË NËNTORI

*Ty, Lavda.*

Shiu gërvishej e dridhej në xham  
sikur më grishte të dilja përjashta,  
me bujë rënkonin strehët e qytetit,  
bregu thërrmonte  
dallgët e ashpra.

Palmat loznin me shqotën,  
pulëbardha  
klithi duke u vërtitur rreth dritareve:  
mbase thirri një emër të dashur  
dhe çau tutje  
mbi kreshtat e dallgëve.

Ç'më pushtuan kujtimet, zërat e ditëve  
që më shkuan te ky qytet i gdhendur mbi shkëmb  
dhe brenda vetes ndjeva, si deti,  
diçka të vjetër  
të më dhembë...

Natyrisht, kjo ndodhi për një çast,  
unë dritaren e hapa e hyri  
gjëmimmadhi det i dehur nga vrulli  
dhe më mbuloi me stërkala  
si lule prilli.

## P È R P I Q U

Dita ditën ndjek,  
e djeshmja diç të bukur na la,  
më shumë na sjell e nesërmja.

Dita ndjek ditën në maja të tjera...  
Bukurinë e jetës e bëjnë këta njerëz  
që ëndrrat i çelin  
me baltë e hekur përzjerë.

Përpiqu të ecësh në një hap me punëtorët  
që njëra ditë mos t'i ngjajë tjetrës, —  
jeta do ketë tingujt e kohës,  
gëzimet, vrullet dhe dritën e rrjedhës.

## D U R R Ë S 1974

Ansamblet u ngjitën  
në skenën e madhe,  
në sfond Shqipëria  
tridhjetëvjeçare.

Të rënë erdhën  
nga Pojska, Qarrishta, —  
përjetë pranë  
më ëndrrat e brishta.

Harku i valles  
(si rreze e vetullës).  
drit' e fustanellës,  
vetëtim' e xhubletës...

Krismë e daulles —  
timpani i alarmit,  
bota mban vesh  
nga vendi i zjarrit,



ku populli flet  
gjuhën e komunizmit  
dhe yjet mbi djep  
karvan i gëzimit.

Çdo gjë popullore,  
për popullin të tëra:  
këngë dasmore  
dhe uvertura.

## VASIL LAÇI

Me pesë kokrrat e plumbit  
flakëroi urrejtja e popullit.  
Vala mbeti mbi breg,  
ullinjte bënë mënjanë,  
nëna e Vasilit ngriti mbi sy  
shaminë e zezë:  
— Hallall qumështin, o bir!  
Shqipërisë  
i duhen kurbanë!

Në rrugë  
spiunë,  
milicë,  
karabinierë,  
të errët e në përgjim si nata  
frymën u merrnin njerëzve.  
Marrshi i egër i pushtuesve  
kreshpëruar  
mbi puplat e këndesëve  
u këput:  
mbi Viktor Emanuelin e tretë

shkreptiu urrejtja e kombit:

— Me plumb  
të jep populli salut!

«E bëra vetë  
për Shqipërinë!» —  
Fjalët me  
pesë plumba  
flakëruan në rrugën e Durrësit  
si pesë lajme:  
po fillonte stuhia...

## NË ISHULL-LEZHË, NËNTOR 1975

Një shtëpi e veshur me gur e dru  
ku shkelim e qeshim me kumbim  
dhe s'presim si nëpër legjenda  
nga dheu  
roje të bulojnë sërish.

Hajati gjëmon dhe dyert vërtiten me vrull,  
gishtërinjtë mbështesim në drurin e bukur  
e ndjejmë në dhoma fëshfërima pishash,  
zëra bilbilash,  
krahun e rosës e shkurtës. . .

Gazi ynë dridhet nëpër ajër,  
në ajrin plot fluturime zogjsh,  
natyra përreth  
me ujëra, drurë e kaçube  
imagjinatën në trille na josh.

Vijmë këtu  
dhe ngrohemi në zjarrin e oxhakut,  
dollitë i ngremë gjer në fund  
dhe këngët gjëmojnë  
tej drurit të pishës e ahut.

Dhe mes këngës  
kokën mbështesim në pëllëmbë,  
Zogjtë tej dritareve përplasim krahët  
e vërtikthi mes këngëve vijnë...

Te kënga hyn traktori që tokën plugon —  
gjer thellë me frymë ajo të ngopet,  
te kënga hyn lezhiani në punë gjer vonë  
me sytë dhe pushkën në katër horizontet.

## TË ASHPËR, TË PRERË ME ÇDO NGJYRË BUOKRACIE!

Net kantieri, net betonimi!  
Yjet mbi ballë na rrëshqasin nëpër djersë,  
siç këputen e bien nga qielli  
mbi gëzimin tonë në festë.

Këtu poet i vërtetë mund të bëhesh dhe punëtor pararoje  
se duarve në beton e hekura  
forcën ua ndjen në rrugët që çan socializmi.  
Një kolonë e re betoni në Metalurgjik  
ngrihet si top sypafjetur pranë kufijve,  
si vezullim i ri gëzimi  
në sytë e njerëzve në bulevardin e dëshmorëve.

Duart që shtruan diga, tunele me pëllëmbë,  
çdo burokrat për zverku e kapin,  
çdo burokraci shkurtojnë me rrënjë:  
S'të lëmë të ngjitesh mbi shpinë të klasës!  
Dhe firmë hedhim me djersë, me punë,

në vend të emrit, në themele të Atdheut  
uzina, hidrocentrale vëmë:  
S'të lëmë, burokraci zuzare,  
të ngrihesh në këmbë,  
s'të lëmë!

Në net kantieri, në net betonimi  
zhvishesh nga pozat, të rremat stoli,  
ndjen rrugët, që çan socializmi  
me duart e klasës në sulm'e stuhi.

## FUNDI I NJË EPOKE

Mbreti Zog u ngjit në skenë me kamxhik. . .  
Si gjithë monarkët kish thika, pranga, litarë.  
Të huaja i kish kostumet, gjeneralët dhe gruan,  
të huajtë kish shahitë në dasmë.

Në kuzhinën mbretërore gatuanin hekura dhe salltanete.  
(Feudalët vetvetes i përuleshin: lepe, peqe!)  
— Vërtet, — çirreshin shërbëtorët e regjimit, —  
si mund të mbahet mbretëria  
pa borxhe, pakte, burgje dhe bankete?

Nga dritarja e pallatit vështroi në rrugë,  
pa popullin që urrejten shtrëngonte në grushte,  
ndër dhëmbë.

Po vinte mbi det  
e zeza tridhjetenëntë.

Nga shkalla e pasme me baullet plot ar  
në Perëndim iku të gjente konak.

Si çdo aktor pas shfaqjes nuk i ndërroi kostumet,  
«Mbase më duhen prapë, — tha, —



kushedi ç'thonë regjisorët atje në mërgim,  
mund të flas nga ballkoni i hotelit  
dhe unë ish-mbreti «legjitim!»

Veç në skenë nuk doli më,  
megjithëse stërvitej përditë në Londër;  
s'bëhej shaka me popullin —  
atje tani do të linte dhe kokën!

## LAVDI E PËRJETSHME

*Dëshmorëve të Atdheut*

Lavdia u takon atyre  
që kurrë s'u thyen në jetë,  
që prapa lanë të panjollosur  
emrin dhe veprën e shtrenjtë.

Lavdi e madhe u përket atyre  
që mbetën në ditët e rojeve,  
dhe ngrihen të parët prapë në këmbë  
kur preket balli i trojeve.

Lavdi e përjetshme u takon atyre  
që gjakun dhe ëndrrat i vunë —  
hekur në jetën e ardhme,  
pë parashikuan ditët tona  
dhe i sollën duke shkelur mbi furtunë, —  
jetën në rremba, dritën në pragje.

## T Ë D U A !

Një pulëbardhë çan muzgun me krahë  
dhe klith mes shkëmbinjve —  
kush e trëmbi?

Të dua.

Portokallet i rrëzuan kokrrat e fundit nga majat.  
Më thellë, më thellë vështromë!  
Në breg të erërave thërras,  
erërat ikën: të dua!

Gjithë ç'përfolën i theu kjo fjalë,  
kjo dashuri  
si dallgë deti.  
Në sy kaltërsia me dantellë stërkale  
dhe mëngjesi i ditëve i hapur na mbeti.

## NDEZËZIT E TRIUMFIT

Tokë e Vietnamit,  
tokë heronjsh punuar nga bombat, gjylet dhe varret —  
rrënjët e lirisë  
i kërkove dhe i gjete thellë trupit tënd  
prej bambuje e hekuri të skuqur,  
me një grusht oriz e me një grusht fishekë  
në udhë e sipër drejt triumfit,  
me betimin e të rënëve gatuar në zemrën e popullit  
dhe në sytë e fëmijëve të burrëruar në afshin e betejave.

Fëmijët nuk provuan lodra,  
po nga djepi i zgjatën duart te armët,  
duart i ngjitën te metali e te luftëtarët.

35-vjet të shurdhuan, ty Vietnam,  
derdhën hekur nga qielli, toka dhe deti,  
po ti rrufetë i thyeje me gjurin tënd pak të përkulur  
para sulmit,  
në gjoksin e shkopsitur të heroit që me sytë nga Jugu  
mbeti.  
35-vjet brinjët e tu krisën, Vietnam,

shpuar me vrer zjarri e helmi, me napalm.  
Tokë e përvëlur, e etur për një fije bar, për një lule,  
poligon i Pentagonit, ku jeta vritej dhe në gur,  
në pragjet e shtëpive, në çdo pëllëmbë mali a fushe. . .

Po helmi shplahej nga gjaku i të rënëve,  
petalet çelnin nga prekja e duarve  
dhe rrënjët ngroheshin nga trupat e bijve të tu, Vietnam!  
Ndaj ngriheshe mes flakëve i pamposhtur, legjendar. . .

\*  
\*   \*   \*

Çdo fund prilli në pragjet vietnameze  
do shfaqet Ngujen Van Troi — ndezësi i triumfeve  
duke shkrepur hidrocentralet e Atdheut,  
dritat e shtëpive e shesheve,  
duke shtyrë me pëllëmbën kreshnike trenat elektrikë  
Jug — Veri.

Do ndalen për një çast rrjedhat e burimeve e lumenjve,  
me harqe ylberësh do mbulohen kataraktet e digave,  
e në hapësirë heroi i varur do lëkundet  
duke matur peshën e vigjilencës pas çdo korrje,  
midis dy zemrave,  
në dy anët e paralelit 17.

Dhe pëllëmba e tij si tërë pëllëmbët e heronjve,  
ngrënë nga dyfeku dhe nga sakrificat,  
do mbështetet në supin tonë:

«Nesër është 1 Maji, mos harroni të merrni fëmijët  
në parakalim,  
por më shumë armën mos harroni mënjanë,  
pas çdo qeshje, pas çdo pragu,  
jankitë si mina me sahat të pranishëm kudo janë!»

## K U J T E S Ë

I bukur është vështrimi sy ndër sy i të dashuruarve,  
qetësia e rrugës në mbrëmje kur era trazon fletët,  
gumëzhitja e plazhit me shkumë, gaz e stërkala,  
një gotë birrë në tavernën e hapur në muzgun veror  
dhe shëtitja në park kur tingujt e orkestrës shuhen pas  
hapave.

Mendimi ynë shtrirë mbi gjithë bukuritë  
trazon gjethe, stërkala, lule dhe udhë...

# Z È R A T E M Y Z E Q E S È

(poemë)

Bregdeti ka stërkala, ashpërsi  
dhe erëra,  
këtu një det tjetër po më deh —  
gruri me aromë shtëpie:  
«Mirë se vjen, djalo,  
mirë se vjen!»

Pranë makinave, lëmenjve  
myzeqarët e qeshur  
me takijen përmbi vetull gjej.

Autokombajnat gulçojnë rëndë-rëndë  
tek vërtiten nëpër fushë  
gati dhe natën të korrin,  
po për grurin do të ecin  
tejmbanë me muaj të tërë.

Presin trupa kalliri,  
(harqe drite këpusin në muzg!)  
dhe drithin në thasë mbledhin myzeqarët  
kokërr më kokërr siç mblidhet xhevahiri.



Mbrëmja s'ka asnjë zë të fshehtë.  
Toka nga thellësitë  
midis grunjërave  
«Mirë se vjen, djalo!» më thërret.  
Duart zgjas mbi tufat e kallinjve  
dhe kokat e rënduara nga buka e re  
u lëmoj mes gishtërinjve.

\*

\* \* \*

Këto mbrëmje të korrash të mëdha  
na rrëmbejnë të gjithëve  
fushave të tua, Myzeqe.  
Tek ti na duket më e ëmbël gjithçka,  
fjalët dhe dashuria,  
uji dhe buka që na dhe.

Dorën mbi ball ngremë,  
mbi fytyrën me djersë,  
erën e bukës  
nëpër trup e nëpër zemër ndiejmë.

Dhe themi se të rritësh grurë  
qenka e vështirë  
(vështirë sa vjershat e poemat):  
duhet të të reshkë dielli e era lëkurën  
dhe gjer natën vonë  
të merresh me të mbjellat,

çdo kokërr farë të mbash në pëllëmbë  
ta shpëtosh nga lagështia e nga ngrica,  
duart t'i kalosh rrënjë më rrënjë.  
Që e shëndetshme të shpërthejë buka  
djersa duhet të rrjedhë pika-pika.

\*

\*

\*

Nata fërshëllen me fyej të hollë kallamash...  
Zgjohen legjendat,  
dridhet e përhidhet truska —  
bukuri e lashtë, e trishtë myzeqare...  
Kërkëllijnë rrotat e qerreve përmes,  
më tutje një gërnëtë klith në vaje...  
E flasin si plaka të lashta, të urta:

Qerret gjer në fyt të përbaltura  
çajne në mes dimrin e jetës,  
grahma e njerëzve këputet  
pas vijave të qerres  
si prapa vijave të fatit:  
Të vraftë vaji, o zot, që na bën sehir neve,  
të vraftë buka, bej, që jetët na merr majë atit!

Û zgjua moçali i rëndë, i zi,  
mushkonjat hapësirat pickojnë.  
Kashta vëzh-vëzh,

mu si plagë,  
rrzë veshëve frushullon.

Dhe vajzat me lotë  
lagnin thërrimet e bukës...  
Natën pa hënë  
rënkonin në shtratin e ftohtë të nuses:

«Korba, nëne, qyqe,  
ku më dhe,  
më dhe poshtë në Myzeqe!  
Shtypin plisa me vare,  
ndajnë bukën me hise,  
ndajnë dhallën me xhezve,  
trupit në rrogos  
këmbët në mbërdhe...»

Kështu lotonte e ecte Myzeqeja,  
pas grurit e pas qerreve  
jetën e vet ngiste  
me hosten të qeve.

Kamxhiku i beut  
përdridhej si gjarpër  
mbi qafën tënde të rrudhur,  
Myzeqe e varfër,  
Myzeqe e bukur.

\*  
\*       \*       \*

Myzeqeja e begatë  
shtrirë tutje-tëhu fushës,  
djepi i këngëve, i ritmeve  
të pambukut e të bukës

Bregdeti ka stërkala, ashpërsi  
dhe erëra,  
këtu një det me grurë të pjekur po më deh —  
gruri me aromë shtëpie:  
«Mirë se vjen, djalo, mirë se vjen!»

Nëpër këmbë shkel udhët e vjetra,  
udhët që pritëshin dikur me ujë e baltë, —  
nxinte e mbyllej çdo shteg,  
nxihej çdo prag.

Dhe duart, që plisat e tharë  
thërrmonin në fushë,  
urrejtjen e klasës  
mblidhnin grusht.

E zemrat që dridheshin,  
si dridhet nga era fleta e misrit,  
gatuanin revoltën,  
hakmarrjen tok me grurin rrisnin.

Dhe nëpër mjegull  
në tymin e vatrës  
sytë e bukur të fëmijëve të tu  
kërkoje, moj Myzeqe e varfër,  
Myzeqe e pasur.

Ndjeje pas vijave të qerreve,  
tek drejtoje trupin e mirrje frymë,  
se me pushkët me yje  
vinte fundi i dertëve.

\*

\*

\*

Shtëpitë e larta me fushën vështrohen  
dhe pemët përreth  
qarkohen si vetull e blertë.  
Shtëpitë lartuar mbi troje kasollesh  
kanë në themele  
gjak dhe djersë  
nga gjithë brezat që u hoqën branë  
tutje-tëhu Myzeqesë  
pa fund, pa anë.

Çdo mbrëmje  
në mes çahet terri atje  
(si pjepër i pjekur)  
me zhurma, shkëlqim e hare.

Po s'flë e s'dehet kurrë  
myzeqari.

Ja, në pëllëmbë i mban kasollet-muze  
kasollet e asaj jete, jetë varri:

Rrogozi i ngrënë,  
tundet pa gjë nëpër erë  
kamastra.

Me tym e blozë që të shpon sytë  
në mes nxin vatra.

Kupat e drunjta  
përdhe, në radhë,  
çerjepi i ndryshkur  
lënë mënjanë...

Sarajet e beut  
me dritë e oxhaqe  
kasollet shtypnin  
me hije e barqe.

Por beut dhe vajtjes me grusht u ramë  
i dogjëm nga themelet  
dhe shtëpitë tona i ngritën të mëdha  
plot diell, plot me dritë,  
oxhaqet la më la  
që të nxihen gjithë armiqtë

Shtëpitë e tua — si jeta të bardha,  
me tre — katër oxhaqe si simbol  
se u shpor beu — gjarpër,  
se nata me përbindshat e kënetës  
u dogjën përgjithmonë.

\*

\*

\*

Drapri bie  
mbi trupa kalliri.  
Myzeqesë në festë  
i qeshet syri.

Dhe një lejlek  
femrën ndjell  
nëpër muzgun e mbushur me grurë  
dhe njerëz tej e përtej.

Edhe fëmijët si zogj  
erdhën në fushë,  
pas kallëzave rendin  
me shallin e kuq...

Mes fletoreve e librave  
një kalli kokërmadh vunë, —  
kalliri që rritet në fushë  
t'u rritet në gjumë.

\*

\* \* \*

Duart e njerëzve,  
ndehur mbi kallinj  
nën ison myzeqare,  
ditë me vrulle e ditë me dasma  
mbajnë në gishtërinj.

Dhe vallja për bukën  
ndizet, e pleqtë  
pas krahëve hedhin vitet,  
etërit me kryet përpjetë.

Dhe vajzat, lulet e fushës,  
dalin në krye  
e lehtë-lehtë majë gishtave  
heqin shamitë e gushës.

Mbrëmja me vete vajzat i merr  
e nënat mbështetur te porta,  
mendojnë qysh pas korrijeve  
në fshat dasmat çdo ziejnë!

\*

\* \* \*

Si brirë kau  
e televizorit antena,



«në këto vende dikur të humbura  
radiot recitojnë poema...»

Dhe stemën e Republikës  
me tufa gruri e thurëm shtëpive në ballë  
që gruri të na fërshëllejë në ëndërr,  
që gruri  
të na rrijë mbi çdo qepallë...

Ja Myzeqeja e begatë  
shtrirë tej e përtej fushës —  
djepi i këngëve, i ritmeve  
të pambukut e bukës.

\*

\*      \*

Bregdeti ka stërkala, ashpërsi  
dhe erëra,  
këtu një det me grurë të pjekur  
po më deh, —  
gruri me aromë shtëpie:  
«Mirë se vjen, djalo, mirë se vjen!»

## N X I T O J

I zhytyr në vrullin e jetës së popullit  
që ditë të reja ngre me ritmin e pranverës  
nxitohj të arrij ata që janë në krye,  
që u këndojnë flamurët në duar —  
direkë ditësh në shkulmet e erës.

Zëra jete janë.

Ecim në shtigjet e vështira  
nga kaluan heronjtë  
e sytë na marrin ngjyrën e qiellit,  
dora na bëhet hekur dhe lule —  
shtrirë nga toka te pushka.

Thirrma fëmijësh si iso himariote  
po zgjojnë dremitjen e mëngjesit.  
Në shtigjet nga kaluan heronjtë.  
gjejmë tokën e bukës  
dhe gëzhojat që hodhën e shpuan fytin e natës.

Gurët të latuar nga plumbat dhe shkrepëtimat,  
gurët me gjurmët e mëdha ku shkelën heronjtë,

i premë dalngadalë, të mos u lëndonim plagët,  
e i vumë në monumente.

Gdhendëm në to yllin pesëcepësh  
dhe betimin tonë grusht mbi ballë.

Zëra jete janë.

Dëgjoj krismën e farës që gërvish tokën,  
burbuqen që shkrep duke thyer xhama të holla dëbore,  
gjëmimet e uzinave që shpien përpara Atdheun  
dhe nxitoj të arrij ata që janë në krye,  
të marr vesh ç'fjalë i thanë farës, burbuqes dhe  
hekurit...

Nxitoj t'i marrë vesh të gjitha,  
zëra të jetës që më rrethojnë si rrjedha lumi.  
Pa to këngët do t'u ngjanin gjetheve të rëna  
që në vjeshtë i merr me vete uji...

## LULE TË LIRISË

*Monolog para eshtrave të dëshmorëve  
që erdhën nga Jugosllavia.*

Flamurët e festave  
me profilin e dëshmorëve  
në qepallat e syrit  
ndëri Shqipëria  
në vend të lotëve.

Shiritin kuq e zi  
vumë në ball të Atdheut,  
Shqipëria e djegur nga malli  
majë gishtave  
shkonte prapa korteut.

Grushtin përpyetë  
e ngritëm,  
kalojmë e ju përshëndesim,  
juve të papërgjunjurve,  
tridhjetë vjet të vinit ju pritëm.

\*

\*     \*

Vijnë nënat, motrat...  
e kuvendojnë.  
Hapi juaj, zëri juaj  
ditët dhe rrugët  
ç'na i mbush!

\*

\*     \*

Të rinj mbetët —  
gërma të lavdisë,  
shtigjeve të luftës —  
lule të lirisë.

Krisin bombat, pushkët  
kur punojmë për bukën,  
me flamurë triumfi  
udhën na e skuqët.

Në çdo rrugë që çelim,  
sytë ku i vëmë,  
sakrifica juaj  
bëhet forcë e këngë.

\*  
\*   \*  
\*

Vijnë nënat  
e buzët u dridhen  
tek shqiptojnë emrat, —  
pranë jush rekëtijnë  
ëndrrat edhe zemrat.

Nënat mplakur nga mosha,  
nënat shamizeza,  
janë si atëherë —  
të forta,  
të reja.

\*  
\*   \*  
\*

Ç'erëra vallë  
ju trazuan flokët,  
ç'plumba e krisma  
ju përshkuan tej  
fjalët edhe gjokset?

Rritur me thërrime,  
rritur o me halle,

shtatin e bukur  
e hodhët sa liria  
në gryka, në male.

Dhe plumbat në dorë,  
gjylet gjëmimzeza  
i mbajtët si ju  
shtigjeve që zutë  
për kohra të reja.

Gjer në Bosnjë vajtët,  
në Maqedoni,  
bëtë luftë të rrallë  
mu si në shtëpi.

\*

\*   \*   \*

Kthehen bijtë,  
fitimtarët, —  
të kuqe i kanë  
rrobat, armët.

Nderin e Atdheut  
e ku s'e shpunë —  
tufan mes sulmeve,  
plumba në furtunë.

\*

\* \*

Gjithë jetën  
na kafshuan armiqtë  
gërmat shqipe,  
mineralet, kufijtë.

E askush s'na dha  
dorën në hall,  
po thikën nga pas,  
buzëqeshjen përballë.

\*

\* \*

Vijnë nënat, motrat...  
e kuvendojnë.  
Hapi juaj, zëri juaj  
ditët dhe rrugët  
ç'na i mbush!

Të rinj mbetët —  
gërma të lavdisë,  
të papërgjunjur  
shtigjeve të luftës —  
lule të lirisë.



## FLETË NGA FËMIJËRIA...

Fëmijërinë e ruaj të gjallë  
me fjalët e nënës, kujtimet e shtrenjta;  
çdo mbrëmje dëgjoj në dritare,  
nga krahët e gushëkuqit të fshatit  
si qelq  
të thyhet heshtja...

Me misërnikën e tharë në xhep  
bënim tutje anëdetit;  
grushtin e vogël tundnim  
mbi kreshtat e valëve  
gjer te luftanijet  
e englezit.

Pas krahëve  
rrihnin çapet e lehtë të etërve...  
Rrugëve e shtigjeve u qepeshin fshatarët,  
pas bandave binin  
me shtatin e madh  
të dyfeqeve.

Mesdheun tej e përtej  
e shponte angloamerikani  
dhe priste volinë të peshkonte  
lirinë e popujve  
e jo një helmetë të shpuar  
gjermani.

Trazonin Mesdheun  
me grykat e topave  
hijeshtrirë mbi Ballkan;  
megjithëse ish fundi,  
trokisnin te porta  
të pinin për fitoren dollinë e parë.

Kështu erdhën buzë Sarandës, Himarës  
po mbi kokë u dolën  
me grykën e nxehtë  
partizanët:  
— Englezë,  
Shporruni tutje, në det!

Kjo tokë të gjitha ia dha luftës.  
Lirinë  
s'e priti nga zbarkimi —  
(ta shkelte mbi shpinë,  
si gjermani dikur,  
ushtari englez).

Ky det le t'ju marrë me vete  
në udhët e ikjes!  
Çdo agresor që na shkel pragjet e shtëpive  
plumbin merr me vete —  
thikë  
midis syve!

\*  
\*            \*

Fëmijërinë e ruaj të gjallë  
me fjalët e nënës, kujtimet e shtrenjta,  
çdo mbrëmje dëgjoj në dritare  
nga krahët e gushëkuqit të fshatit  
si qelq  
të thyhet heshtja.

Të vegjël ishim,  
po duart s'i mbanim në xhepa,  
kulakët vëngër vështronim  
e dilnim të ruanim bregdetin  
mbi guva e shkrepë.

\*

\* \*

Fëmijëri e bukur  
me zile mushkash dhe rrahje dallgësh,  
unë bëj tutje  
ti pranë më qasesh;  
dhe zëri i nënës, zërat e shokëve  
në net me yje e ëndërrime  
më derdhin gaz e frymëzime!

## N Ë V E N D R O J E

Kam kohë që pres në vendrojen time.  
Praninë e shokëve dhe të dashurve e ndjej,  
përpëlitjen e syve të bukur ku shkrepin ylberët,  
dorën e ngrohtë...

E rrok me vështtrimin e armës tërë këtë tokë  
bleruar nga prilli,  
majat që çikin me krahë thëllëzat,  
dehur nga erërat, dehur nga blerimi,  
ku shkelin njerëzit përmbi trëndelinë  
me kokën te yjet dhe malet mbi shpinë.

Toka tkurret e ftohet  
dhe ferrat dridhen, fletët zverdhen e bien...  
Në pyll një egërsirë ulërin,  
një tjetër më afrohet mua.  
Dikush kalon në vijën e shënjestrës sime,  
dikush kalon e ngrin  
si bimët në thëllime!...

## E P I K Ë

Në këtë dhe ranë mbretëri e shtete  
ardhur monopateve në terr,  
ardhur me gjemi ndër dete  
me flamurët si gjuhën zeher.

Dhe rënkonte e shpatullat kriste  
toka mëmë shamizeza,  
nga gjoksi trimat i nxirrte  
si florinjte e gushës në vallet, e reja. <sup>1)</sup>

Nxori Dedë Gjo Lulë e Çerçizë  
me fjalën dhe plumbin të rëndë  
sa peshë e armëve të lirisë,  
dhe Mihalín me martinë e pendë.

Ngado që vanë, në Paris a Londër,  
s'i hoqën nga trupi armët e vjetra,  
se çka nuk mbaronte dot fjala e penda  
do ta mbaronte pushka, e nxehta.

---

1) E reja — nusja

Mes furtunës dolën deviatorë  
me ngjyrën e meitit në fytyrë,  
trembur nga Fuqitë me top e taborrë;  
— Larg të ikim! — thanë me gjak të ngrirë. —

E të lemë vatrat, gjithçka që krijuam!  
Grurin, vreshtat dhe ullinj të,  
t'i shkelë në mesditë këmbë e huaj  
dhe me to të na qëllojë sërish.

Pa u ngritën trimat radhë-radhë  
hodhëm pushkë e mbetën në shkëmbinj e gryka,  
të rrezojnë deviatorë e mbretëri,  
të rrezojnë si yll me çika.

Lindim në rrethim e çamë rrethime,  
në shtëpitë bërë mur kalaje;  
çajmë si krismë vetëtime,  
hyjmë në këngë e në valle!

## K R O N I K Ë L U F T E

Mure të patundur malesh  
lidhur thellë me konturet e fushës,  
ngjeshur me çdo shkurre e çdo shkrep të kufijve  
të Atdheut,  
që me gjuhë zjarresh lajmërojnë ardhjen e luftës  
me një gjysmëhënë në Shqipëri plagosur...  
Ja ku vjen si rrebesh  
me ushtarë të egër, të pasosur.

U ngjeshën kullat, frëngjitë —  
sytë luftarakë të qyteteve, shtëpive e burimeve  
dhe kokën dykrenare në shesh të betejave e nxorën  
në Krujë, Stelush e në Shkodër,  
breg më breg ku kërciste topi,  
ku shigjeta thyhej kodër më kodër.

Frëngji e kulla janë gurët, shkëmbinjtë,  
pragjet e shtëpive kufitare.  
Gati janë  
si mure të patundur rreth maleve krutane.

Kruja ditën piqet në zjarrin e topave,  
natën arnon muret.



Mure të lartë me gjokse trimash.  
Asgjë s'do të bjerë.  
Në kala u ngjit dielli, në kampin turk  
përkulet gjer përdhe një gjysmëhënë e mjerë.

Përsipër doli Vrana Konti me xhamadan zbërthyer.  
Të gjitha i kish legjendare:  
zërin, mustaqet dhe pallën.  
Mure të patundur me trima të patundur.  
Vrana Konti sokëllin,  
korbat lëkunden sipër kokave të turqve,  
sipër udhëve të tyre.  
Korbat trokasin. Vetëm korbat i qajnë në  
një farë mënyre.

Prapë rojet morën shërbimin në kufi —  
sytë e Atdheut që shohin gjer në Edrene e Stamboll.  
Po kur mbarojnë shirat,  
majë më majë më nuk nisen thellë në Arbëri  
të sjellin kushtimin gjer tek ne:  
aty mbeten të patundur si malet ngulur nëpër re  
si kjo tokë e këta njerëz nëpër kohëra, kështjellë  
e karakoll.

Për Atdheun të kemi rënë e jemi vvarë  
dhe lart e kemi ngritur  
mbi tyta të nxehta koburesh e pushkësh...

## P Ë R M B I G Ë R X H E . . .

Në këto brinja më nuk fluturojnë  
në gryka, maja, trimat e brigadave,  
po era prapë nga toka ngre  
gjëmimet e kushtrimeve, alarmeve.

Pepino, fricë, poshtë në hone  
kanë rënë e s'pipëtinjë, —  
kujtimi, qetësia si në çdo varrezë  
nuk vjen në kokë t'u rrijë.

Një këngë zgjon luginat, brinjat  
dhe toka thellë ngazëllen:  
të rinjt e fshatit përmes agimeve  
në luftë për bukën venë.

Gërxxhet kthejnë në toka buke,  
të piqet misri, gruri, —  
trimërisht si partizanët  
bukë e ujë  
të nxjerrin dhe nga guri.

## G J I T H N J Ë U S H T A R

Në këto vise ku shërbeva  
po vij si një ushtar i vjetër,  
janë po ato brigje e rrëpira  
ku vigjeluam a përdhe fjetëm.

Kam mall komandën të dëgjoj,  
të nisem në marshim,  
në natë, shi e erë  
të hidhem para për luftim.

Në poligon buria të ushtojë  
si krismë vetëtime,  
me mitraloz tabelat të rrëzoj —  
«armiqtë» e tokës sime.

Shërbimin prap' të marr  
në net me suferinë  
kur fjal' e komisarit të jep zjarr  
dhe ideali horizontet ndrin.

Gjithnjë nën armë, gjithnjë ushtar,  
atdhe, për ty gatitem,  
pran' teje i pamposhtur jam,  
pran' tokës i pamposhtur ngrihem.

## LUFTËTARËT E HIMARËS

Dorë për dore fushës mbinë  
rrobëbardhë e mjekërzinj,  
i zgjoi orë e dasmës që me natë —  
lufta me bori, klithma e gjak.

Madhëtorë e pallëndritur  
si tufan me fustanella,  
nga dielli ballëpërzhitur  
shkelën si mbi drapër gjysmëhënën

ardhur me barut e topa  
të qëllojë majë në majë,  
malet t'i merrte hopa  
si deshë për kurbanë.

Pa u ngritën valë-valë  
djem e vajza mu si drita,  
me armët si zemrat-pranë,  
në beteja e në prita.

E mbetën në këmbë, luftëtarë  
të pathyer si vetë jeta,  
vallet të rënda i kanë  
me lule e me brenga...

E mbetën të ndiqnin armiqtë  
si të gjallë dhe në vdekje,  
kurorë iu bënë lirisë  
me armët si buzëqeshje.

Madhështorë e pallëndritur  
mbi parmendë e në përleshje,  
si tufan me fustanella  
ngado i kemi me vete.

## THEMELET E JETËS

(poemë)

Në udhët e jetës e mësuam historinë, —  
na e thanë nënat punëmira,  
na e tha ylli mbi bustinë,  
lapidarët, gurë fitoresh,  
që si farë të jetës  
vetëtijnë:

Atdheu i ndezur në pragje e male, —  
me yje të kuq po vinte liria,  
që me dritë spërkatnin  
si harqe ylberi  
ditët e tua,  
ditët e mia.

Me flamurët e brigadave,  
Atdheu i hekurt  
hidhej në sulme,  
nga supet po shkulte armiqtë e egër ...

Pas makinave të rënda gjermane,  
që hiqnin shpirt në udhët e ikjes,  
reaksioni  
pështillej spondeve  
me tmerrin e popullit —  
peshën e gjyqit.

Pushteti i popullit  
lindi nga lufta, me grykë pushke.  
Në themelet e shtetit të ri  
dritë hidhte ylli  
dhe shqipja me flatra  
në fushën e kuqe.

Nëntori i kuq, gjëmimmadhi  
plot shkëlqim,  
kishte llamburitjen e gjithë ditëve tona.  
Pushkën e luftës hodhëm mbi supe  
e dolëm në zyra, kufi e ara  
në patrullim.

Prapë si në luftë  
dolën çetat, batalionet e punës;  
hodhën shtatin e urave të rindërtimit  
dhe lanë atje betimin e shenjtë:  
«Liri popullit,  
Vdekje fashizmit!»



Bregdeti i bukur heshtte  
mbjellur me hijen e minave gjermâne,  
që pezull qëndronin  
mbi jetën e re — në shenjë  
gati të zbraznin  
vdekjen kobzezë.

Dhe lulja e re dridhej  
e vala stepej...  
Po erdhën xhenierët partizanë,  
çminuan rrugët  
dhe shkelën në fyt trimërisht  
heshtjen e vdekjen.

Jetën e re ndërtonte  
pushteti i popullit  
me rrënjët te lufta.  
Shqipëria e tërë ngritur më këmbë  
të vinte drita,  
të rritej buka.

Do t'i bënim të gjitha vetë  
dhe bukë, basma e dritë;  
Partia me dritën e idealit  
na printe përpara  
dhe ne përgjunjm  
vetë stuhitë.

\*

\*     \*

Pushteti i popullit —  
themeli i Atdheut sovran, të patundur  
qëllonte në koskë  
armiqtë e klasës,  
gjithë plehrat  
vrimave strukur.

Dora jonë  
ra vetëtimë mbi borgjezët;  
tatimi i jashtëzakonshëm  
mbi fitimet e luftës  
u preu kyçet,  
u theri gjunjët.

Shoqëritë e huaja,  
kangrenë e Atdheut,  
i konfiskoi shteti:  
armiqve damarët iu prenë  
siç shemben themelet  
nga balli i tërmetit.

S'do kish më tregti ari e kontrabandë!  
Si t'i linim spekulatorët  
të pinin prapë gjakun e popullit  
gjakosur në luftë,

djegur strehët  
e lënë pa bukë?!

Mbi kokën plot grerëza të spekulatorëve  
shpata e Pushtetit vetëtinte  
e hovin, si një shkëmb, ua priste  
me vigjilencën  
dhe të pamëshirshmet  
ligje.

\*

\*

\*

Do bënim çelik e basma,  
do bënim televizorë e dritë,  
Partia me idealet e komunizmit  
na printe përpara  
dhe ne përgjunjm  
gjithë tradhtitë.

Dëshmorët i mblodhëm  
ngado ku plumbi i hasmit të egër  
i kapi;  
u betuam mbi eshtrat e tyre  
me krismën e rrufeve,  
me zë luftëtari:

Do bëjmë Shqipëri të bukur  
më të bukur se çdo ëndërr e jetës,  
që me mallin për ju në gji  
të dalim përreth  
e t'ju gjejmë  
të gjallë në çdo vepër!

Antikomunizmi reaksionin e ndezi,  
fashistët buluan sërish, —  
i pamë në tribuna të koloviten  
nën ritmin Truman;  
me qerren daj Sam  
të formojnë kabinete qeverish.

Shantazhet — fluska  
pëlqisnin në brigjet tona,  
Tirana kuqllonte flamurët  
dhe ne, që me natë,  
të nesërmen ngjitnim  
kolona-kolona.

Parashutat binin —  
kërpurdha me helm;  
tyta diversantësh  
ditët e reja,  
Pushtetin  
vunë në shenjë.

Parashutat kishin në bark  
llokume e fletushka-mina,  
Vallë, ne gjakun lumë  
si mund ta shkëmbenim  
me kularin e ri fshehur  
pas stafidheve të ngrira?!

Borgjezët me qypa floriri groposur në dhe  
s'i lamë të na majmen mbi kurriz.  
I flakëm në katër udhët:  
— Ja bukën tënde  
nxirr kokulur,  
ja vdis!

Në litar i shpumë diversantët,  
reaksionin në tëmtha  
qëlluam me armë  
(në kondakun e saj, në pushimet e luftës,  
gdhendëm me gëzhoja  
yllin prej gjaku, yllin e zjarrtë).

\*

\*

\*

Vijat e ujit —  
shtatin e blerimit, frutave e bukës —

i shtetëzuar.  
Gurgullimat do ngopin  
tokën tonë  
nga etja në shekuj thërrmuar.

Në çdo prag fshati e fushe  
do shpërthente gëzimet Reforma.  
I dehur me plisa në duar  
fshatari i varfër  
ndjente bollëkun,  
regëtinte së thelli dhe toka.

Ç'ëndërr e lashtë!  
Tapitë ndau vetë Enveri, —  
s'mjaftuan këngët  
atë ditë  
të shprehnin harenë  
me gjëmime deti.

\*

\*

\*

Jetës së re i printe Partia,  
Pushteti i popullit  
me rrënjët te lufta.  
Shqipëria e tërë ngritur më këmbë —  
po vinte drita,  
po rritej buka.

Selita e ftohtë s'e dinte,  
Tiranën do ushqente me dritë;  
Yzberishi do gdhihej  
me trupin beton e hekur,  
do cicërinin makina e vajza  
gëzimet e Atdheut për të endur.

Dhe Maliqi malarik,  
tharë nga vullnetarët,  
sheqer do shpinte  
te bufetë e reja;  
djersa valë do rridhte  
në grurë e dritë...

Pushteti i popullit  
lindi nga lufta me grykë pushke.  
Në themelet e jetës  
dritë hidhte ylli  
dhe shqipja shpalosur  
në fushën e kuqe.

Këtu i ka rrënjët  
Metalurgjiku,  
këtu u skicua Fierza  
në imagjinatën e njerëzve  
rritur në luftëra,  
pjekur në vepra:

Bëjmë çelik e basma,  
bëjmë televizirë e dritë, —  
Partia me idealet komuniste  
na prin majave  
dhe ne përgjunjim  
vetë stuhitë.

Ndërtojmë Shqipëri të bukur,  
më të bukur  
se çdo ëndërr e jetës,  
me pushkën në dorë  
e syrin mbirë  
mbi shënjestër.



## PASQYRA E LËNDËS

Poezia .....	3
Fund dhjetori .....	5
Këngë për fshatin tim në bregun e detit (poemë) .....	6
Zaho Koka .....	23
Dasëm në fshat .....	25
Vjeshta dhe foletë e zogjve .....	29
Të arrish njerëzit .....	31
Ndërgjegje .....	33
Partizani i vogël .....	34
Motiv autobiografik .....	35
Jeta përreth më bukur na i tha .....	38
Shtigje të çelura .....	39
Himariote .....	41
Ëndërr lirike .....	43
Buka .....	44
Mall .....	45
Poema e parë për dashurinë .....	46
Kuptimi i jetës .....	60
Drita e syrit të kaltër (poemë) .....	62
Saranda në një ditë nëntori .....	77
Përpiqu .....	79
Durrës 1974 .....	80
Vasil Laçi .....	82
Në Ishull — Lezhë, 1975 .....	84

Të ashpër, të prerë me çdo ngjyrë burokracie! .....	86
Fundi i një epoke .....	88
Lavdi e përjetshme .....	90
Të dua .....	91
Kujtesë .....	95
Ndezësit e triumfit .....	92
Zërat e Myzeqesë (poemë) .....	96
Nxitoj .....	106
Lule të lirisë .....	108
Fletë nga fëmijëria .....	113
Në vendroje .....	117
Epikë .....	118
Kronikë lufte .....	120
Përmbi gërxhe .....	122
Gjithnjë ushtar .....	123
Luftëtarët e Hin'arës .....	125
Themelet e jetës (poemë). .....	127

Tirazhi 1.500 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

---

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1976